

Tiranë, më 27.05.2021

PUBLIKIM I VENDIMIT PËR NDRYSHIMIN E KAPITALIT

Në përputhje me nenin 24, shkronja "e" të ligjit nr.9662, dt.18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" dhe miratimin e Bankës së Shqipërisë për zvogëlimin e kapitalit të BANKA e TIRANËS Sh.A.

Në përputhje me nenin 182 të ligjit nr. 9901, dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", BANKA e TIRANËS Sh.A bazuar në vendimin e Mbledhjes së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarit të Vetëm mbajtur më 28.04.2021, njofton sa vijon:

1. Qëllimi i zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit aksionar

Viti 2020 për BANKA e TIRANËS Sh.A., tregon një Bankë të mirëkapitalizuar me Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) në nivelin 16.1% në Dhjetor 2020. CAR final në Dhjetor'20 vlerësohet rreth 17.3%, përfshirë fitimin e kapitalizuar të vitit 2020 (5 milion Euro shtesë), vlerë kjo mbi nivelin rregullator prej 15% aplikuar aktualisht për BANKA e TIRANËS Sh.A.

Aksionerët e BANKA e TIRANËS Sh.A. vendosën të ulin kapitalin aksionar të regjistruar dhe të paguar në mënyrë që të mbulojnë humbjet e mbartura dhe të pasqyrojnë më mirë pozicionin financiar të Bankës, duke përthithur të gjitha humbjet e viteve të mëparshme, me efekt prapaveprues që nga 31.12.2020, në vlerën prej 38.115.621,98 Euro (tridhjetë e tetë milion, njëqind e pesëmbëdhjetë mijë, gjashtëqind e njëzet e një Euro e nëntëdhjetë e tetë Euro cent).

2. Përshkrimi i zvogëlimit të thjeshtëzuar të kapitalit aksionar**(1) Shuma e zvogëlimit të kapitalit**

Kapitali aksionar i BANKA e TIRANËS Sh.A. prej 79.911.819,47 Euro (shtatëdhjetë e nëntë milion, nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë, tetëqind e nëntëmbëdhjetë Euro dhe dyzet e shtatë Euro cent) pas uljes me 38.115.621,98 EUR (tridhjetë e tetë milion, njëqind e pesëmbëdhjetë mijë, gjashtëqind e njëzet e një Euro e nëntëdhjetë e tetë Euro cent), do të arrijë në total në vlerën 41.796.197,49 Euro (dyzet e një milion, shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë, njëqind e nëntëdhjetë e shtatë euro dhe dyzet e nëntë Euro cent).

(2) Forma e zvogëlimit të kapitalit

Zvogëlimi i vlerës nominale të aksioneve TIRANA BANK nga 159,19 (njëqind e pesëdhjetë e nëntë Euro dhe nëntëmbëdhjetë Euro Cent) në EUR 83,263504 (tetëdhjetë e tre Euro dhe dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë dhe pesëqind e katër Euro cent) secili.

(3) Struktura e kapitalit pas zvogëlimit

Kapitali aksionar pas zvogëlimit do të mbulohej si vijon:

Aksionari i Vetëm	Vlera nominale (EUR)	Nr. i aksioneve	Pjesëmarrja (EUR)	Pjesëmarrja (%)
Balfin – Balkan Finance Investment Group Sh.p.k	83,263504	501.975	41.796.197,49	100,00
TOTAL	83,263504	501.975	41.796.197,49	100,00

3. Perspektiva

Reduktimi i kapitalit aksioner të regjistruar dhe të paguar të BANKA e TIRANËS Sh.A. për të mbuluar humbjet e mbartura nuk do të ndikojë në kapitalin total të BANKA e TIRANËS Sh.A., as kapitalin rregullator dhe treguesit përkatës, që marrin në konsideratë kapitalin rregullator për llogaritjen e ekspozimeve dhe kufijve. Prandaj, Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit (CAR) vazhdon të jetë brenda limitit rregullator dhe nuk ka asnjë efekt në performancën e BANKA e TIRANËS Sh.A.

Tirana Bank Sh.A

Dritan Mustafa
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Elvira Kapoli
Drejtuese e Divizionit të Financës

